



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 234/Prot.
7

Patos më 06.02.2025.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 03.02.2025

I mbajtur sot më datë 03.02.2025 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Liljana Mesutaj
2. Novrus Toska
3. Elmira Rama
4. Vjollca Kasaj
5. Enkelejda Ajazi
6. Erald Çepele
7. Albiona Lamaj
8. Ertilla Myrtaj
9. Lori Musaj
10. Klaudio Alisininaj
11. Renaldo Shpata
12. Artan Velçani
13. Armand Ahmetaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar anëtar të këshillit bashkiak!

I nderuar Kryetar i Bashkisë!

Të nderuar qytetar!

Kjo është mbledhja e radhës e këshillit bashkiak. Mbledhja është e bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53 dhe 56.

Pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit është 13 këshilltarë.

Mbledhjen e deklaroj të hapur!

Përpara së të lëxoj rendin e ditës kemi ndonjë propozim për të shtuar apo për të hequr nga rendi i ditës.

Nuk ka.

Kalojmë në rendin e ditës.


- 1- Miratimi i rendit të ditës.
 - 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 30.12.2024.
 - 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.12.2024.
 - 4- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Dhjetor 2024".
 - 5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Dhjetor 2024".
 - 6- Projekt-vendim "Për miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2025 nga fondet e trashëguara".
 - 7- Projekt-vendim "Për miratimin e kontratës së qirasë nr. 161 prot., datë 15.01.2025 të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier, me objekt qiraje "Rruga hyrse, peshorja dhe vend-depozitimi i mbetjeve urbane".
 - 8- Projekt-vendim "Për miratimin e zbatimit të projektit të rikonstruksionit të rrugës lidhëse Frashër-Fshat i Ri, Zharrëz".
 - 9- Raporti vjetor për dëgjuesat publike për vitin 2024.
- Armand Ahmetaj- Rendi i ditës është hartuar konform rregullave të caktuara.
Armand Ahmetaj- Kush është dakord?
Miratohet me 13 vota pro abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Rendita Gjyshe


Albiona Lumoj


Arta Lekoni


KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 234 / Prot.
8

Patos më 06 .02.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.02.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 30.12.2024

Armand Ahmetaj - Nëse ka ndonjë propozim, apo vërejtje ?

Nëse ska pyetje atëherë quhet i ezuaruar.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Renaldo Shpate

Albiona Lamoj

Artan Këreni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 234/Prot.
19

Patos më, 06 02.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.02.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 30.12.2024

Armand Ahmetaj– Fjala për Sekretaren!

Refaela Xeba,

Përshëndetje të gjithëve!

Ju njoftoj se për mbledhjen e datës 19.12.2024 ka ardhur dhe përgjigja e Prefektures në përputhje me ligjin, konkretisht për vendimin nr. 87 dhe 90. Ndërsa për mbledhjen e datës 30.12.2024 u mor gjithsej një vendim i cili i kaloi drejtorisë përkatëse për ekzekutim.

Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba

Bendolë Shyreta

Albisma Lamaj

Artan Veliani

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr 219/Prot.
3

Patos më 06 02.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.02.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Dhjetor 2024”.

Armand Ahmetaj- Kjo pikë ka kaluar në komisionin e Ekonomisë, nëse nuk e shihni të nevojshme të dëgjojmë bashkinë mund të kalojmë në votim. Materialet i keni pasur në dispozicion. Nëse s’kemi pyetje siç ju thash pak më parë ka kaluar në komisionin e Ekonomisë dhe ka kaluar për në këshill me të gjitha votat pro.

Armand Ahmetaj – Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

Bendita Shyqte

Albioma Larmaj

Artan Velcani

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 220 Prot.
3

Patos më 06 02.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.02.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Dhjetor 2024".

E njejta gjë ka ndodhur edhe me këtë pikë, është mbledhur komisioni i Ekonomisë dhe i ka kaluar këshillit me votë unanime për shqyrtim.

Armand Ahmetaj – Nëse s'kemi pyetje të tjera kalojmë në miratim.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për miratimin?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Rendbo Shyde

Albiona Lomaj

Antan Veliani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr 231 Prot.
15

Patos më 06.02.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2025 nga fondet e trashëguara”.

Armand Ahmetaj- Ftojmë ekzekutivin

Mimoza Shtëmbari, Drejtore e Financës- Përshëndetje të gjithëve!

Ky projektvendim vjen si kërkesë për miratim pasi është bërë akordimi dhe vlerësimi i vitit 2024. Nga rakordimi që është bërë më degën e thesarit paraprak zbatimi i buxhetit për vitin 2024 analizat e ekzekutivit kanë përgatitur relacionin dhe projektvendimin dhe kemi këto vlera.

Buxhet shtesë i cili vjen nga këto burime.

Të ardhura lokale të trashëguara 145 milion e 874 mijë.

Transferte të pakushtëzuar e trashëguar 83 milion e 862 mijë.

Transferte specifike e trashëguar 49 milion e 83 mijë.

Në total ne trashëgojmë 278 milion e 819 mijë lekë.

E gjithë kjo sipas këtyre burimeve që unë përmenda është e shpërndarë dhe do të përdoret sipas klasifikimit të mëposhtëm.

Shpenzime korrente fianacim dhe angazhime të cilat janë miratuar me buxhetin e 2024 por që ende janë të pafinancuara sepsë janë kontrata në vazhdim, dhe fatura të dhjetorit 10,220,166.

Shpenzime korrente fianacim është shtesa sipas vendimit nr. 94 ne kemi marrë një vendim për shtimin e 10 punëtorëve sezonalë për 6 muaj dhe do të mbuloheshin nga fondet që ne do të trashëgonim dhe është detajuar dhe buxhetuar me vlerën e projektvendimit. Shpenzime kapitale financime dhe angazhime të 2024 146 milion e 986 mijë dhe shpenzime kapitale financime shtesë të reja 110 milion e 941 mijë

Në total siç shpenzimet dhe burime të balancuara sipas relacionit shoqërues dhe tabelave shoqëruese ju kemi paraqitur gjithë objektet e investimeve që janë në vazhdim dhe angazhime të 2024 dhe objektet që të jenë si objekte të reja shtesë për buxheti vitin 2025 sipas tabelës referohen një nga nje materialin e keni në analizë sipas objekteve që nuk janë realizuar dhe do të financohen për vitin 2025 dhe objekteve të reja të cilat do ti shtohen si financime të reja buxhetit të 2025.

Kryetari i Bashkisë –

Përshëndetje të gjithëve!

Përsa i përket fondeve të trashëguara pjesa me e madhe e tyre do shkojnë për investime në infrastrukturë dhe një nga ndërhyrjet e para është rikonstruksioni i rrugës Ali Laze dhe Qerim Gropa. Rruga Ali Laze është rruga tek pompat por duke filluar nga pallatet francezë dhe do lidhet me rrugën Qerim Gropa që lidhet me rrugën që mbyllet nga investimi i Vreshtit duke bërë komplet pjesën e unazës te ura e vogël te Fatos Xhufi dhe aty mbyllet komplet rruga e unazës me lagjen e Vreshtit.

Një pjesë e mirë e konsideruar e lagjes së re mbyllet më këtë investim.

Pjesa e trotuareve është prashikuar që të bëhen nga ASHP dhe do kaloj afër pallateve sepse anës rrugës nuk e bën dot.

Siç ka filluar pjesa mbrapa pallateve Francezë do lidhet deri tek pompa dhe të vazhdojë më tej deri tek lagja e Re që të vazhdojë shëtitë nga pjesa e urës te Lagjja e Re që duhet të kenë filluar sot punimet edhe do të lidhen bashkë që të jetë një segmenti i gjithi.

Te pjesa rikonstruksioni i rrugëve Kripallarëve që fillon tek varrezat edhe përfundon deri tek shtëpia e fundit tek lagja e Kripallarëve.

Ky është investim tjetër atje është besoj pjesa më madhe juaj e di gjendjen që është janë parashikuar të gjitha rrugicat dhe lagje dhe rruga kryesore segmente ku ndahen një në të dhjathtë dhe një në të majtë. Me këtë investim mbyllet pjesa e Dukas Kripallarë.

Pjesa e mbikqyrjes së kolaudimit është për rikonstruksionin e rrugës lidhëse Frashër Fashti i Ri Sheqishte që është një pikë tjetër e mbledhjes së sotme që është investim i Bankersit. Duke qënë se në Grizë Lënginas shpërndarja e kontinierëve për mbetjet u bë në çdo familje, duke qënë së rrethinat, rrugicat janë shumë të ngushta lind nevoja krahas makinës së mbetjeve që morëm që është 20 m3 mos gaboj na duhet dhe një makinë tjetër për mbledhjen e kontinierëve të vegjël. Ka një vlerë investimi për blerjen e makinës prej 5 milion lekë, vlera e rrugëve kripallarëve është 50 milion lekë ndërsa vlera e Ali Laze 20 milion lekë. Gjithashtu është para e nevojshme dhe blerja e një kamiocine tjetër me vlerë e parashikuar prej 3 milion lekësh.

Pak a shumë këto janë nga fondet e trashëguara që kemi për këtë vit

Nëse kenë ndonjë pyetje?

Armand Ahmetaj- Dua tju kërkoj ndjesë se në fillim doja tju njoftoja në lidhje me një riorganizim të grupit të partisë Socialiste të grupit të këshilltarëve. Në datën 20.01 me shkresë 4440/1 nga partia Socialiste vendoset në dijeni se kryetari i partisë Socialiste do të jetë Z. Artan Velçani.. Kjo bëhet në funksion të rregullores.

Këshilltarja Znj. Suela Hoxha prezent.

Erald Çepele- Lidhur me pjesën e projektvendimit për miratimin e fondeve të trashëguara, e kemi diskutuar dhe në komision por duke qënë se materiali na ka ardhur siç është bërë traditë me vones, e kemi votuar në parim por unë nuk jam dakord lidhur me pjesën e ndërtimit të fushave të basketbollit pasi mesa kam në dijeninë time nga dëgjesat publike mua nuk më rezultoi që kjo është një nga prioritetet që ka ngritur komuniteti në dëgjesa publike. Ka gjëra më madhore që duhet të diskutohen të futen. Kështu që unë do mendoja ose dhe do propozoja në rast se do miratohet dhe nga shokët, do kërkoj të marrim dhjetë minuta pushim për të marrë një vendim për ta ndryshuar këtë pikë nëse është e mundur. Mendoj se në bashkinë e Patosit janë katër shkolla përfshirë dhe gjimnazin që kanë fusha basketbolli plus pranë stadiumit që u ndërtua ajo e reja kështu që mendoj se janë mjaftueshëm për këtë moment që jemi kështu që mund të bëhen çdo vit të ndërtojmë nga një. Sivjet mund ta bëjmë në Zharrëz pavarësisë së Zharrëza është futur në rikonstruksion shkolla që mund të përfshi dhe palestrën e re që mund të ketë dhe fushë basketbolli, volejbolli brenda, mendoj që ti propozoi kolegëve të kërkoj 10 minuta pushim ose ta hedhim në votim në rast se do të miratohet propozimi im.

Unë mendoj që është më i nevojshëm përmirësimi i infrastrukturës rurale që këto fondet 10 milion 500 mijë lekë të reja të kalojnë për infrastrukturë rurale të mbështeten fermerët, parcelat, shtrimi i rrugëve dhe ose mund të blihen dy mjete që janë domosdoshme një vinç kosh që i duhet ndërmarrjes së Sherbimeve Publike për të ndërhyrë për të ndërruar llambat dhe një mjet traktor me pajisje për të pastruar bankinat e rrugës, që i duhet kryesisht zonave rurale. Një mjet me goma, zëtor me pajisje për të pastruar bankinat e rrugëve dhe kanalet me atë grirësen dhe një mjet me vinç ose të kalojnë në infrastrukturën ndihmëse për bujqësinë kanale, shtrim rrugësh, me stabilizantë me çakull, kështu që mund të lëm në një moment të dytë që çdo vit ne ta pasurojmë, nuk është se është Patosi pa fusha basketbolli . Dakord jam me vizionin e Kryetarit por për këto kapacite të sotme ne kemi mjaftueshëm fusha. Kështu që propozoj ta hedhim në votim.

Kryetari i Bashkisë- Koncepti i fushës së basketbollit është fushë basketbolli që ka kosha, fushë volejbolli në mes dhe që ka dhe dy porta për të luajtur futboll. Të shtunën isha në Griz, ka një hapësirë atje që është shkolla, që ka një ambient mbrapa shkollës goxha të madh që fëmijët luanin mes lagjes, mes rrugës me dy topa, me dy porta me gurë dhe luanin futboll.

Nuk besoj se është më e rëndësishme një rrugë bujqësore pa u vënë në diskutim fare sesa ambjentet që të luajnë fëmijët, që janë e ardhmja. Vërtet duhen rrugët bujqësore, ne e kemi rritur dhe fondin për rrugët bujqësore por nuk besoj pa e anashkuar se janë të rëndësishme dhe ato, të gjitha janë shumë të rëndësishme, por jo më të rëndësishme se të ketë ambjente për fëmijët. Te lagjja ime fëmijët luajnë futboll në rrugë, vënë dy gurë dhe luajnë futboll, ambjentet e shkollës janë tjetër gjë. Përveç të tjerave duke luajtur futboll në rrugë rrezikohen sepse ska siguri. Të parët janë fëmijët pastaj ne. Kjo është ideja.

Armand Ahmetaj- çështje të rregullores Erald me gjithë respektin paraprakisht para se të bëjmë një propozim edhe për herë të tjerë kjo punë nëse bëhet një propozim i caktuar depozitohet paraprakisht në sekretarinë e bashkisë dhe në lidhje me të paktën duhet mbështetesh nga dy këshilltarë të tjerë që themi këshillit të vazhdojë me pushim apo me ndryshim të vendimit që kemi marrë dhe në komisione sepse nuk ka sens që në komision është votuar unanimitisht nuk ka asnjë shënim në procesverbal .

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim “Për miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2025 nga fondet e trashëguara”.

Miratohet me 13 vota pro, 1 kundër , abstenim ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba



Benedek Shyrate



Alleisma Lomaj



Anton Veljan



KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 161/4 Prot.

Patos më 06 02.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.02.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e kontratës së qirasë nr. 161 prot., datë 15.01.2025 të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier, me objekt qiraje "Rruga hyrse, peshorja dhe vend-depozitimi i mbetjeve urbane".

Ekzekutivi relaton materailin Nurka Hazizaj- Përshëndetje të gjithëve

Sikurse keni dijeni me vendimin e këshillit të bashkisë nr. 95, datë 19.12.2024 i është dhënë dakordësia nga ana e këshillit kryetarit të bashkisë për rinovimin e kontratës së qirasë dhe nënshkrimin e saj. Pas marrjes së dakordësisë për rinovimin e kontratës së qirasë është vijuar me hapin tjetër e cila ka të bëjë me nënshkrimin e kontratës së qirasë nga bashkitë e qarkut dhe nga agjencia e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara tiranë kjo kontratë qiraje konsiderohet një kontratë e rinovuar, kushtet e kontratës janë të pandryshuar si dhe kontrata e vitit 2024 tarifa është po e njejtë afati njëvjeçar me të drejt rinovimi kushtet dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve nuk kanë ndryshuar.

Përsa më sipër i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin në parim të kontratës së qirasë për të cilën është dhënë dhe dakordësia paraprakisht nr. 161 prot., datë 15.01.2025 të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier, me objekt qiraje "Rruga hyrëse, peshorja dhe vend-depozitimi i mbetjeve urbane".

Kryetari i Bashkisë- Përsa i përket traktorit me pajisjen që pastron kanalet po ta shohësh te pasqyra përmbledhëse e investimeve tek pika 2 është dhe pajisje korrëse automatike për ndërhyrjen e rasteve emergjente që është lënë tek fondi I MZSH që është parashikuar për vitin tjetër. Me buxhetin që do jetë kur të transferohet Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile që ne nuk mund ta kalonim tani pa ardhur fondi është parashikuar dhe për marrjen e një traktori për pastrimin e kanalit.

Armand Ahmetaj –Kush e do fjalën? Meqënëse nuk kemi propozoj për ta hedhur në votim pikën shtatë.

Kush është dakord

Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2301 / Prot.
13

Patos më 06.02.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.02.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e zbatimit të projektit të rikonstruksionit të rrugës lidhëse Frashër-Fshat i Ri, Zharrëz”.

Ekzekutivi relaton materailin.

Ermenita Mici- Përshëndetje të gjithëve!

Ky projektvendim ka të bëjë me zbatimin e projektit të rikonstruksionit të rrugës lidhëse Frashër-Fshat i Ri Zharrëz pas kërkesave dhe të shumta dhe të banorëve bashkia e ka marrë në shqyrtim të segment rrugor dhe ka hartuar projektin për rikonstruksionin e këtij segmenti që përfshin lidhjen mes dy fshatrave dhe përbënë total 1.15 km projekti është hartuar nga bashkia Patos financimi për këtë projekt do të kryhet nga kompania Bankers Petroleum dhe siç u cek dhe më parë tek buxheti i kërkojmë këshillit të bashkisë që të miratojë zbatimin e projektit rikonstruksioni rrugës lidhëse e Frashër-Fshat i Ri Zharrëz me vlerë 11,999,245.06 e cila do të financohet nga kompania Bankës dhe miratimin e vlerës 204,591.05 e cila përfshin shërbimin e mbikqyrjes dhe kolaudimit të projektit dhe do të mbulohet nga bashkia Patos.

Artan Velçani- Komisioni i Shërbimeve u mbledh me shumicë votash në datën 29.01.2025 dhe mori në shqyrtim projektvendimin përkatës pasi e konsultoi dhe nga pikëpamja ligjore është në formatin e duhur ftojme këshillin që ta miratoj.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë Projekt-vendim Për miratimin e zbatimit të projektit të rikonstruksionit të rrugës lidhëse Frashër-Fshat i Ri, Zharrëz”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Berolbo Shyoto

Albiona Lumaj

Artan Velçani

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 233 Prot.
1

Patos më 06.02.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 03.02.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Raporti vjetor për dëgjesat publike për vitin 2024.

Armand Ahmetaj- Si ta gjykoni nëse e keni të nevojshme për ta dëgjuar, këtë e them pasi e keni patur si material. Kjo pikë nuk ka nevojë për miratim.
Atëherë kjo ishte pika e fundit. Mirupafshim dhe gjithë të mirat!

SEKRETARE
Refaela Xeba

Remonda Shyete

Albiona Larmaj

Artour Veliani

KRYETAR
Armand Ahmetaj